



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-SC-2025-06

Vendosi: Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryesuese

Gjykatëse Kristinë van den Vajngart

Gjykatës Daniel Fransen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 8 gusht 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje Afati dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve

Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Pjetër Shalës::

Zhan Lui Zhilisen

Mbrojtjes së Viktimave:

Sajmon Loz

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SUPREME i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës Supreme” ose “Paneli”), duke pasur parasysh nenin 48(6) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullat 4(2) dhe 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), dhe nenet 36(1) dhe 56(3) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzuesi i Punës”), lëshon këtë vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve lidhur me Kërkesën e saj për Mbrojtjen e Ligjshmërisë (“Kërkesa për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve” ose “Kërkesa”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykses I lëshoi “Aktgjykimin”, në të cilin, ndër të tjera, shpalli fajtor Pjetër Shalën (“z. Shala”) për krime lufte të ndalimit arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe e dënoi atë me 18 vite burg, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.²

2. Më 14 korrik 2025, Panel i Gjykatës së Apelit lëshoi “Aktgjykimin e Apelit” ku ndër të tjera, konfirmoi pjesërisht fajësinë e z. Shala për krime lufte të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e anuloi dënimin e z. Shala prej 18 vitesh dhënë nga Trupi Gjykses dhe e uli atë në dënim prej 13 vitesh, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.³

3. Më 23 korrik 2025, Mbrojtja e z. Shala dorëzoi Kërkesën për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve.

4. Më 28 korrik 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi Përgjigjen e

¹ F00001, Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 23 korrik 2025.

² KSC-BC-2020-04/F00847, Aktgjykim dhe Dënim me një Shtojcë Konfidenciale, 16 korrik 2024 (konfidenciale), para. 1037-1039, 1086, 1103-1108, 1121-1122, 1124.

³ KSC-CA-2024-03/F00069, Aktgjykimi i Apelit, 14 korrik 2025 (konfidencial), para. 938. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit të Apelit u lëshua më të njëjtën ditë (KSC-CA-2024-03/F00069/RED).

Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kërkesën e saj për Mbrojtjen e Ligjshmërisë,⁴ ku ZPS-ja e kundërshton Kërkesën (“Përgjigja e ZPS-së”).⁵

5. Më 4 gusht 2025, z. Shala dorëzoi Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë (“Kundërpërgjigja”),⁶ e cila u njoftua ditën e nesërme.

II. DISKUTIM

6. Z. Shala pretendon se ka arsye bindëse për t’i miratuar zgjatjen e afatit prej 60 ditësh për të dorëzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë deri më 12 dhjetor 2025, për të shqyrtuar sa më mirë Aktgjykimin e Apelit i cili është i gjatë dhe përfshin çështje komplekse ligjore dhe bën parashtrime kuptimplota.⁷ Duke iu referuar rregullës 76 të Rregullores, z. Shala parashtron se e ka paraqitur Kërkesën paraprakisht, menjëherë pas pranimit të Aktgjykimit të Apelit, sikurse kërkohet me Rregullore.⁸ Z. Shala parashtron më tej se përkthimin zyrtar në shqip të Aktgjykimit të Apelit do ta marrë vetëm më 14 nëntor 2025 dhe përkthimin jozyrtar më 12 shtator 2025.⁹ Ai përmend gjithashtu një numër faktorësh që kanë të bëjnë me kufizimet logjistike si kapacitet të kufizuar të ekipit për shkak të pushimeve verore dhe pakësimit të buxhetit, gjë që e pengon Mbrojtjen të parashtrojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda afatit të kërkuar. Së fundi, z. Shala kërkon një shtim prej 9,000 fjalësh të numrit të lejuar të fjalëve, duke marrë parasysh “numrin, rëndësinë dhe kompleksitetin e çështjeve që

⁴ F00003, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 28 korrik 2025.

⁵ Përgjigja e ZPS-së, para. 1,6.

⁶ F00004, Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 5 gusht 2025.

⁷ Kërkesa, para. 2, 4.

⁸ Kërkesa, para. 3.

⁹ Kërkesa, para. 4; poshtëshënimet 1-2.

do të ngrihen në Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë”.¹⁰

7. ZPS-ja parashtrohet se zgjatja e afatit për z. Shala për të paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, që është një kërkesë ligjore, nuk lejohet mbështetur në jurisprudencën e mëparshme të Panelit, i cili parashihte vetëm mundësinë për ndryshimin e afateve të rregulluara me Rregulloren.¹¹ Sipas ZPS-së, z. Shala duhet rrjedhimisht ta dorëzojë kërkesën deri më 14 tetor 2025.¹²

8. ZPS-ja parashtrohet më tej se përmendja nga z. Shala e pamjaftueshmërisë së numrit të lejuar të fjalëve, numrit, rëndësisë dhe kompleksitetit të çështjeve që duhen trajtuar në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, pa shpjeguar se si këta faktorë e përligjin shtimin e numrit të lejuar të fjalëve, nuk e përmbush kriterin e rrethanave të jashtëzakonshme dhe arsyeve bindëse të kërkuara për miratimin e kësaj kërkesë.

9. Në Kundërpërgjigje, z. Shala thekson se zgjatja e afatit dhe shtimi i numrit të lejuar të fjalëve janë të përligjura për t’i garantuar atij të drejtën për një gjykim të drejtë. Duke iu referuar vendimit të lëshuar nga Gjykata Supreme mbi kërkesën e z. Salih Mustafa për mbrojtje të ligjshmërisë (“Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë i z. Mustafa” ose “Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë”), z. Shala pretendon se Paneli ka thënë se “sipas rregullës 183(4), i pandehuri (z. Mustafa) duhet ta marrë Aktgjykimin e Apelit në një gjuhë që e kupton ‘sa më shpejt që të jetë e mundur’ për të ushtruar të drejtën e tij për të kërkuar mbrojtjen e ligjshmërisë”.¹³

10. Paneli i Gjykatës Supreme mban parasysh kërkesën e z. Shala dhe argumentet e tij në mbështetje të saj. Paneli i Gjykatës Supreme vëren më tej se rregulla 9(5)(a) e Rregullores parasheh që një panel mundet, pasi t’i paraqiten arsye bindëse, të zgjasë apo të shkurtojë çdo afat të paraparë në Rregulloren ose të vendosur nga Paneli” (theksi i

¹⁰ Kërkesa, para. 1,8.

¹¹ Përgjigja e ZPS-së, para.2.

¹² Përgjigja e ZPS-së, para. 2.

¹³ Kundërpërgjigja, para. 3.

shtruar). Megjithatë, Paneli i Gjykatës Supreme më parë ka deklaruar se periudha tremujore brenda të cilës duhet të kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë në lidhje me një aktgjykim të formës së prerë parashihet në nenin 48(6) të Ligjit. Duke qenë një afat ligjor, i përcaktuar për të garantuar sigurinë ligjore, ai është absolut dhe sipas hierarkisë së burimeve, nuk mund të ndryshohet me Rregullore.¹⁴ Ligji nuk jep ndonjë bazë ligjore për ta ndryshuar këtë afat. Rrjedhimisht, dhe ndryshe nga afatet për njoftimet e apelit, mocionet, përgjigjet apo kundërpërgjigjet, të cilat rregullohen me Rregullore, Gjykata Supreme nuk mund të ndryshojë afatet e parapara shprehimisht me ligj,¹⁵ pavarësisht nga pretendimi i z. Shala në lidhje me kohën e marrjes së përkthimit në shqip të Aktgjykimit të Apelit.

11. Në këtë drejtim, Paneli i Gjykatës Supreme, dëshiron të vejë në dukje se Mbrojtja e z. Shala po e keqinterpreton Vendimin për Mbrojtje të Ligjshmërisë të z. Mustafa.¹⁶ Në atë vendim, Paneli i Gjykatës Supreme, duke pranuar rëndësinë e marrjes së Aktgjykimit të Apelit në një gjuhë që z. Mustafa e kupton, peshoi edhe faktorë të tjerë, të cilët kompensojnë aspektin e marrjes së përkthimit në shqip, duke mos konstatuar asnjë shkelje në këtë drejtim.¹⁷

12. Në kuadër të çështjes së z. Shala, problemi bazë është i njëjtë dhe konstatimet e Panelit të Gjykatës Supreme në Vendimin për Mbrojtje të Ligjshmërisë të z. Mustafa mbeten relevante. Në veçanti, Aktgjykimi i Apelit doli në anglishte, që është gjuha e punës në proces, duke përfshirë edhe apelin. Për më tepër, z. Shala është ndihmuar gjatë gjithë procesit të apelit nga Mbrojtja e tij që e zotëron gjuhën angleze dhe në këtë

¹⁴ KSC-SC-2024-02/F00009, Vendim mbi Kërkesën për Zgjatjen e Afatit, 25 janar 2024, para. 12; Krahaso me rregullën 4(2) të Rregullores.

¹⁵ Krahaso ICTY, *Prosecutor v. Duško Tadić*, Case No. IT-94-1-A, Decision on Appellant's Motion for the Extension of the Time-Limit and Admission of Additional Evidence, 15 October 1998, para. 36 ("ndërsa Rregullorja mund të ilustrojë kuptimin e Ligjit sipas të cilit është bërë, ajo nuk mund ta ndryshojë Ligjin").

¹⁶ KSC-SC-2024-02/F00018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024.

¹⁷ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 39-42, 44.

mënyrë është në gjendje të ndihmojë në interpretimin dhe shpjegimin e aktgjykimit si edhe në përgatitjen e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë. Në veçanti, sikundër ky Panel ka vendosur më herët, një kërkesë për mbrojtje ligjshmërie është “krejtësisht me natyrë ligjore, dhe është kryesisht përgjegjësi e Mbrojtës, [...] [i cili] është në gjendje të këshillojë [klientin e tij] lidhur me një kërkesë për mbrojtje ligjshmërie pa pasur përkthimin zyrtar të Aktgjykimit të Apelit”.¹⁸ Për më tepër, sikurse vihet në dukje nga z. Shala, përkthimi jozyrtar në shqip pritët të jetë gati deri më 12 shtator 2025. Kjo është më shumë se një muaj nga përfundimi i datës për dorëzimin nga z. Shala të kërkesës së tij për mbrojtje ligjshmërie. Kështu ndodhi saktësisht edhe me Vendimin për Mbrojtje të Ligjshmërisë të z. Mustafa. Rrjedhimisht del se argumentet e z. Shala në këtë drejtim janë pa bazë dhe duhen hedhur poshtë.

13. Për sa i takon Kërkesës për Zgjatje të Afatit dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, Paneli i Gjykatës Supreme vëren se z. Shala kërkon dyfishin e numrit të fjalëve të paraparë në nenin 56(3) të Udhëzuesit të Punës. Në këtë drejtim, Paneli i Gjykatës së Apelit pajtohet me ZPS-në se thjesht përmendja nga z. Shala e pamjaftueshmërisë së numrit të fjalëve, pa treguar se si faktorët e përmendur mbështesin një shtim kaq të madh, nuk mjafton për të përligjur ekzistencën e rrethanave të jashtëzakonshme apo ndonjë arsyeje bindëse në mbështetje të kërkesës së tij.

¹⁸ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 42.

III. VENDIM

Për arsyet e mësipërme, Paneli **HEDH POSHTË** Kërkesën për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryegjykatëse

E premte, 8 gusht 2025
Në Hagë, Holandë